

Raporti i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis

Aktiviteti: “Depo e skrapit të hekurit, përfshirë ato nga automjetet” dhe “Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale” të subjektit Shijaku sh.pk me adrese Arramenas, Fushe Kruje, Bashkia Kruje, Qarku Durrës.



Pergatitur nga A Consultant Sh.p.k

Shtator 2018



Permbajtja

1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI,.....	4
a. Hyrje.....	4
b. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.....	8
Flora & Fauna.....	8
c. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.	11
2. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;	13
a. Uji, akuiferet	13
b. Relievi dhe klima.....	14
3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR; ...	15
a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne toke.	16
b. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.....	16
c. Shkarkimet ne ajer.....	18
d. Zhurmat.....	18
e. Fenomene te tjera.	18
f. Gjenerimi i mbetjeve	19
g. Ndikime ne biodiversitet.....	19
4. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;.....	19
a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.	19
b. Shkarkimet ne ajer.	21
c. Zhurmat.	22
h. Fenomene te tjera.....	22
i. Gjenerim i mbetjeve	23
5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;.....	27
6. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;.....	27

7. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;	28
8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;	34
- Identifikimi i masave zbutese.	34
- Vleresimi i efektivitetit te prËtshem te masave zbutese.	38
9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË);.....	39
10. SIGURIA DHE SHENDETI NE PUNE DHE PERGJEGJSHMERIA SOCIALE E KOMPANISE.....	40
11. KONKLUZIONE	44
12. Licenca e qkl-së, të A Consultant shpk dhe eksperteve per hartimin e raportit të vnm-së.	46

1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI,

a. Hyrje

Subjekti SHIJAKU Sh.p.k ushtron aktivitetin e tij si “Transportim, grumbullim, perpunim dhe riciklim i mbetjeve ferroze dhe jo ferroze” me adrese ne Fshatin Arameras, Fushe – Kruje, rrethi Kruje, qarku Durres.

Subjekti eshte i regjistruar ne QKR (Qendra Kombetare e Rregjistrimit), si dhe eshte i pajisur dhe funksionon sipas legjislacionit ne fuqi. Subjekti Shijaku per aktivitetin “Transportim, grumbullim, perpunim dhe riciklim i mbetjeve ferroze dhe jo ferroze” zoteron Akt-Miratimi, Leje Mjedisoreme vendim nr.14 i K.SH.K me Nr.Indentifikues 1260, Nr. 289/21 Prot. date 19.06.2013 te Ministrise se Mjedisit.

Aktiviteti i propozuar ndodhet ne Arramenas, Fushe Kruje, Qarku Durres. Nje pamje e vendodhjes dhe kordinatat e aktivitetit jepen me poshte.




Figura 1. Pamje nga google earth per vendndodhjen e aktivitetit.





Figura 2. Pamje e zmadhuar e vendit ku do te ushtrohet aktiviteti.

Planimetria e objektit me siperfaqet respektive jepet me poshte:



Rr. Donika Kastrioti Str. Building No.14/1, 3th Floor,
Ap.6, Tirane.Tirane, Web:<http://shijakugroup.al/>,
Email: shijakushpk@hotmail.com,

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania
email: aconsultantal@gmail.com ; web:
aconsultant.com.al Cel: 0696032083




Figure 3. Skica e aktiviteti te Shijaku:


1. Zyrat dhe magazine bojrash, grafiato etj, Sip=747m²
2. Magazine, Sip=873m².
3. Magazine, Sip=1, 606m².
4. Magazine, Sip=1,302m².
5. Mence, Sip=226m².
6. Impianti i perpunimit te skrapit, Sip=6,293m².
7. Magazina e motorreve, Sip=2,549m².
8. Kanal kullimi ne drejtimin veri-jug dhe tombino ϕ 100 lindje-perendim (me ngjyre te verdhe)
9. Vendparkimet e administrates, Sip=177m².
10. Vendparkimet e klienteve te ndryshem, Sip=217m².
11. Vendqendrimet e mjeteve te transportit te mallrave, Sip=2,063m².
12. Kontenier per magazinimin e mbetjeve te ndryshme sipas lendes dhe natyres, Sip=3,000 m².

Siperfaqja e prones:	48 363 m ²
Siperfaqja e ndertuar	6 303 m ² +
Siperfaqe e betonuar	46,100 m ²
Koeficienti i shfrytezimit me ndertese	13.03%

Me nr pasurie 325/58, 325/59, 12/19,
12/17, 12/18, 12/27, 12/43, 12/42, 12/13, ,
Zona Kadastrale1042 12/30, 12/44

Siperfaqja totale e aktivitetit te Shijakut eshte 48,300 m².

Siperfaqja e shtimit te aktivitetit do te jet 3,000 m² dhe do te konsistoj ne kontenier te palevizshem ose kontenier ne forme rimorkoje. Lendet mbetje do te magazinohen ne brendesi te konteniereve dhe ne raste te lendeve te lengeta ato do te jene te ruajtura ne ene te vecanta.



Te gjitha rruget e kantierit jane te shtruara me beton dhe kapin siperfaqen 9549m² duke perfshire impiantin e perpunimit te skrapit edhe vendparkimet e ndryshme.

Vendodhja e objektit eshte ne koordinatat e meposhtme:

Tabela nr. 1 Koordinatat e Vendndodhjes se fabrikes se Shijaku sha

Pika	x	y
1	475948.502	4593520.754
2	476006.602	459351.364
3	476068.202	4593405.264
4	476033.902	4593382.164
5	476053.200	4593141.200
6	475946.800	4593309.200

b. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.

Zona Gjeografike: Qarku i Durrësit ka një popullsi prej 277.450 banorë. Ai përbëhet nga tre bashki. Bashkia Durrës Shijak dhe Krujë. Qyteti i Durrësit është qyteti më i rëndësishëm në Qark, i cili është edhe qendra e Prefekturës dhe e Qarkut Durrës. Bashkia Kruje perbehet nga keto njesi administrative kryesore Krujë, Fushë – Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë dhe Cudhi. Zona ku eshte projekti i subjektit te Shijakut ndodhet ne Arramenas, Fushe Kruje. Kjo zone gjendet ne Njesine Adminsitrate te Fushekrujes e cila perbehet nga Qyteti Fushë Krujë, Fshatrat; Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luze 2, Larushke 2, Arrameras 2. Zona ku operon Shijaku Sh.a eshte nje zone industriale e cila shtrihet ne buze te autostrades Tirane-Lezhe, dhe kryesit ka bime karakteristike te zones si dhe bime dekoruese. Per sa i perket ekosistemeve dhe habitateve ato shtrihen ne disa zona pyjore dhe me shkurre.

Flora& Fauna

Qyteti i Fushë Krujës shtrihet në luginën e lumit Ishëm në një lartësi 30m mbi nivelin e detit. Në një distancë jo më të madhe se 2 km prej qytetit në Lindje janë

kodrat e Krastës dhe pas tyre vargmali Skënderbeut. Qyteti shtrihet tërësisht në një situatë fushore që në pjesën më të ulët në Perëndim është 23 m mbi nivelin e detit dhe në pjesën më të lartë në Lindje 34 m, duke pasur një pjerrësi 1 % ose 0.6 °. Në një distancë 4.5 km në Perëndim të qytetit gjendet brezi i kodrave kepi Rodonit – Vorë, që ndajnë luginën e lumit Ishëm me luginën e lumit Erzen.

Një mori elementësh, si: larmia e formave të relievit me kodra të buta dhe faqe të pjerrëta malesh, bimësia që varion nga tokat e punuara të fushave, makjet mesdhetare në kodrat e ulëta dhe pyjet e dushqeve, ullishteve apo më lart drurët halorë, pasuria e ujërave sipërfaqësorë, një qiell i pastër në pjesën më të madhe të vitit, që lejon një shikueshmëri të lartë etj, i japin territorit përreth qytetit një vlerë të veçantë peisazhistike.

Klima mesdhetare dhe territori përreth ofrojnë kushtet e përshtatshme për zhvillimin e frutikulturës dhe në veçanti të ullinjve dhe vreshtave. Ullishtet janë pjesë e identitetit mesdhetar të qytetit si dhe gjithë qyteteve të ultësirës perendimore të vendit. Pasuritë e ujërave sipërfaqësorë. Territori ka një pasuri hidrike të ujërave sipërfaqësorë me lumenj dhe liqene. Këto liqene kryesisht artificialë janë prej vitesh pjesë e ekosistemit dhe kanë diversifikuar florën dhe faunën nëpërmjet llojeve të peshqve dhe bimëve të kultivuara në to.

Zhvillimi i biodiversitetit

Flora dhe fauna e zonës kanë qënë historikisht të dëmtuara për shkak të përdorimit të tepërt të resurseve natyrore. Efekti më i dukshëm dhe më i ndjeshëm është shpyllezimi i tej skajshëm i kodrave të Krastës, gjë që sjell për pasojë edhe pakësimin e habitateve. Tjetër problematikë është fragmentarizimi i habitateve natyrore dhe si rrjedhojë biodiversiteti biologjik nuk paraqitet i pasur. Diversiteti i rajonit duke përfshirë këtu edhe kodrat e Krastës dhe të Zgërdheshit janë të influencuara nga elementët e klimës mesdhetare. Fragmentarizimi i habitatit është

mjaft i theksuar në të gjithë zonën që rrethon qytetin e Fushë-Krujës. Një problem për këto zona është ndryshimi i destinacionit të territoreve të kthyer nga pyje në kullota. Negativisht ndikon edhe afërsia e madhe me rrugët nacionale si Tiranë-Shkodër, Fushë-Krujë- Krujë, duke tjetërsuar këto habitate si pasojë e zhurmave të automjeteve dhe pluhurit të vazhdueshëm.

Flora

Flora e zonës mbizotërohet nga një llojë shkurreje tipike për rajonet e mesdheut (maquis), pisha (pinus heldreichi), është gjithashtu karakteristike për zonën, këto të fundit janë të mbjella aty prej më shumë se 40 vitesh. Prezenca e elementeveve të tillë si shqopa (Erica arborea), pemë ulliri e egër dhe e kultivuar (Olea oleaster dhe Olea europea), lisi (Quercus Cerris), etj. janë evidence që kjo është një zonë tipike mesdhetare. Gjelbërimi i lartë në formën e mirfilltë të pyjeve është i rrallë për territorin e bashkësisë, kryesisht pyjet shtrihen në kufi me Krujën dhe kryesisht në bimësi mbizotërojnë specie e sipërpërmendura. Si rezultat i shpyllzimit masiv dhe prerjes pa kriter të pyjeve në zonën e industrive të rënda kemi një tjetërsim të ekosistemit në këto zona. Zonat më të dëmtuara janë territoret e karrierve të gëlqeres. Mes këtyre shtresave të dheut dhe heqjen e bimësisë në këto zona, do të prishen edhe vendbanimet e faunës (gjitarët, shpendët, amfibët, zvarranikët.) së bashku me çdo lloj specie tjetër që popullon ato zona.

Fauna

Fauna e zonës dallohet për prezencën e dhelpres (Vulpes vulpes) dhe të lepurit (Lepus capensis). Por numri i këtij të fundit është zvogëluar në mënyrë progresive në numer për shkak të gjuetisë së pa liqshëm. Gjithashtu janë gjetur të tjerë gjitarë si nuselala (Mustela nivalis), dhe ketri (Sciurus vulgaris). Sigurisht që bazuar në vendodhjen e habitateve natyrore egzistuese dhe pakësimin e tyre rrjedhimisht për

arsye të gjendjes së disa prej tyre në zonat e paura me gurë gëlqeror, numri I gjitarëve të zonës është zvogëluar ndjeshëm si pasojë e zvogëlimit të shtrirjes së sipërfaqes së habitatit të tyre natyror. Varfërimi dhe degradimi I habitatit është shkaktuar kryesisht në zonat pyjore si pasojë e shpyllzimit dhe e ndërthurjeve të shumta njerëzore, keq menaxhim të tyre dhe mbi-shfrytëzim. Problemet e përmendura më sipër sigurisht që kanë influencuar në gjendjen e faunës dhe gjitarëve në vecanti. Njekohësisht impaktohet edhe popullata e zogjve të zonës. Në numër të konsiderueshëm mund të përmendim specie e thëllëzës, shapka, mëllenja etj. Gjithashtu gjenden specie si: harabel, trumcak, breshkë, trishtil I verdhë (Gardelius gardelius) etj. Në zonën e Fushë-Krujës mungojnë elementet endemiketë faunës. Sigurisht shpyllzimi nuk favorizon qetësinë e tyre. Zogjtë e medhenj si: gjyqja, hutë apo shqiponja nuk I gjejmë (ndërkohe që nuk janë të rrallë për zonat e tjera të Shqipërisë). Ka edhe specie të tjera kalimtaresi p.sh bufi që e zgjedhin këtë vënd vetëm për të gjetur ushqim.

c. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.

Siperfaqja qe do te shfrytezohet eshte zone fushore, terreni eshte i shesht ku mungon tektonika. Keshtu nuk do te kemi ndryshim te konfiguracionit te zones dhe siperfaqes qe do te perdoret per ndertimin e objektit.

Pejsazhi do te jete afersisht i njejte me ate ekzistues.

Ne aspektin litologjik

Gjeologjikisht, sheshi qe kerkohet nga subjekti per tu vendosur impjanti eshte i perbere nga depozitime te kuaternarit argjila dhe suargjila, me ngjyre gri ne kafe, te perajrosura mire.


Ne fotot e meposhtme jepen pamje te cilat ndodhen ne afersitesubjektit:



Figura 4. Pamje ne pjesen perpara subjektit Shijaku sh.a

Aktualisht ne kete zone ku do te zgjeroj gamen e aktiviteve subjekti kryen dhe ka leje mjedisi per aktivitetin e grumbullimit te mbetjeve ferroze Nga zhvillimi i aktivitetit te të subjektit SHIJAKU Sh.a pritet te kete ndikime ne mjedis. Aktiviteti do te zhvillohet teresisht brenda nderteses dhe ambienteve qe jane te shtruara me betone dhe qe jane sistemuar ne vite nga subjekti

Meqense aktualisht subjekti zhvillon aktiviteti ne kete hapsire, si rrjedhim te gjitha ndikimet qe lidhen me fazen e zenies se siperfaqes se tokes dhe ndertimi te objektit jane kryer kohe me pare, ne fokus te ketij raporti VNM paraprake do te jene vetem



ndikimet nga pershtatjet dhe shtesat e rregullimet e ambjenteve dhe te ndertesese dhe nga funksionimi i aktivitetit. Keshtu qe ne pjesen me poshte do te analizohen dhe pershkruhen ndikimet e mundeshme nga ky aktivitet per pershtatjen dhe modifikimin e ambjeteve dhe gjate funksionimit te tij.



Figura 5. Pamje anash subjektit

2. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;

a. Uji, akuiferet

Territoret e bashkisë së Krujes bëjnë pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Ishëm, Zeze dhe në pellgun ujëmbledhës të detit Adriatik. Kurrizi kodrinor Rodon-Erzen shërben si kufi ndarës i pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve të mësipërm. Pjesë të caktuara të fushës së Rinasit dhe ne drejtim te Lezhes, të cilat kanë pjerrësi të vogël nga niveli i detit, i derdhin ujërat ne kanalet kulluese, lumin Zeze dhe Ishem ose direkt në detin Adriatik. Rrjeti hidrografik sipërfaqësor përfaqësohet nga deti Adriatik, lumenjtë (Zeze dhe Ishëm), përrrenjtë, proskat, objektet ujore artificiale si:

ujëmbledhësit dhe kanalet kullues të ndërtuar para viteve '90. Territoret e bashkisë së Krujes kanë shtrirje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore. Ujërat nëntokësore gjenden shumë pranë sipërfaqes së tokës. Cilësia e ujërave nëntokësore nuk është e mirë për të furnizuar banorët me ujë të pijshëm. Ushtrimi i aktivitetit të propozuar nga subjekti nuk ndikon në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore të zonës.

Në zonën ku është ndërtuar objekti ku do vendoset aktiviteti verilindje në distancë 50 m kalon lumi Zeze. Në jug-perëndim të objektit në distancë 1,400 m kalon lumi i Ishmit. Në afërsi të objektit kalojnë kanal kullues që mbledhin ujërat e fushës dhe përfundojnë në lumin Ishem. Këto trupa ujorë nuk ndërveprojnë me objektin në fjalë.

b. Relievi dhe klima

Objekti i kërkuar bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare pranë Adriatike. Dimri përgjithësisht është i butë e më lagështirë, ndërsa vera është e nxehtë dhe e thatë. Në zonë ka mbi 2 180 orë ndricim djellor, Korriku 362 orë dhe Dhjetori 118 orë. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është 14.8 °C, në Gusht temperatura shkon 36 °C, ndërsa në Janar zbrit në raste të vecanta deri - 1 °C.

Vlera mesatare e rreshjeve shkon rreth 1580 mm/vit. Në periudhën Tetor-Maj, bien rreth 75 % e rreshjeve. Sasia maksimale e rreshjeve është regjistruar gati 90 mm shi në 24 orë. Në periudhën e dimrit dominojnë rreshjet e shiut ndërsa rreshjet e deborës janë të rralla. Lagështia e ajrit rezulton sipas stinëve nga 65 % - 80 %.

Drejtimi i erës është kryesisht nga jugu në veri, në disa raste era fryn nga perëndimi në lindje që favorizohen nga disnivelet e larta të terrenit dhe luginat e krijuara nga lumi Zeze me lartësitë e vargmalit të Kruje-Dajtes me një diferencë të madhe kuote mbi 650m. Të dhënat për klimën jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2. Të dhënat për klimën

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Temperatura mesatare(°C)	8.1	9	10.9	14	18.1	21.8	23.8	23.9	21.2	17.2	13	9.9
Temperatura minimale (°C)	4.8	5.6	6.9	9.7	13.6	17.2	19	19	16.5	13	9.5	6.5
Temperatur maksimale (°C)	11.4	12.5	14.9	18.3	22.6	26.5	28.7	28.8	26	21.4	16.6	13.3
Temperatura mesatare(°F)	46.6	48.2	51.6	57.2	64.6	71.2	74.8	75.0	70.2	63.0	55.4	49.8
Temperatura minimale (°F)	40.6	42.1	44.4	49.5	56.5	63.0	66.2	66.2	61.7	55.4	49.1	43.7
Temperatura maksimale (°F)	52.5	54.5	58.8	64.9	72.7	79.7	83.7	83.8	78.8	70.5	61.9	55.9
Rreshje / Shi (mm)	132	107	99	81	68	41	26	36	71	112	160	131

3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR;

Sikurse theksuam me siperaktualisht, subjektit SHIJAKU Sh.aka nje leje mejdisi dhe zhvillon aktivitet te grumbullimit te mbetjeve kryesisht ferroze. Keshtu qe te ndikimet qe lidhen me fazen e ndertimi te objektit nuk jane ne fokus te ketij raporti VNM paraprake. Ne kete raport VNM-je do te analizohen dhe pershkruhen ndikimet e mundeshme nga ky aktivitet gjate punimeve per pershtatjen dhe modifikimin e nderteses dhe siperfaqeve ekzistuese si dhe ndimet funksionimit te aktivitetit te shtuar.Nga zhvillimi i aktivitetit te : “Depo e skrapit të hekurit, përfshirë ato nga automjetet” dhe“Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale” mund te kete ndikime ne mjedis.



a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne toke.

Toka ku eshte vendosur godina dhe do te zhvillohet aktiviteti eshte ne ane te autostrades Kamez – Fushe Kruje dhe eshte percaktuar si zone industriale ne planet e zhvillimit urban te ish Bashkise Fushkruje dhe aktualisht te Bashkise Kruje.

Gjate fazes se funksionimit nuk pritet te kete ndikime te medha dhe shkarkime ne toke nga zhivillimi i ketij aktiviteti. Sepse cdo proces i ruajtjes se lendeve te para (mbetjeve), zmontimit dhe ndarjes se tyre, sistemimit dhe magazinimit te tyre perpara tregetimit kryhen ne kryesisht ne ambjente te mbyllura ose te shtruara me beton.

Sikurse theksuam me lart subjekti ka marre gjithe lejet e nevojshme per aktivitetin e dhe po aplikon per VNM paraprake dhe me tej per pajisjen me leje mjedisi.

b. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.

Gjate aktivitetit te grumbullimit dhe magazinimit te mbetjeve te ndryshme nuk pritet te perdoret uje dhe te kete shkarkime te qenesishme ne uje. Procesi i keti aktiviteti eshte nje proces i thjesht i cili konsiston ne zmontimit, ndarjen, sistemimin/magazinimi dhe pergatitjen e mbetjeve te ndara sipas natyres, lendes dhe destinacionit te perdorimit te tyre final.

Uji ne kete aktivitet do perdoret vetemper qellime higjene dhe pastrimi te ambjenteve te aktivitetit. Per mbledhjen e ujerave te perdorura per qellime higjene dhe pastrim te ambjenteve subjekti do te ndertoht pervec atyre ezksistuese nje sistem kanalizimesh qe perfundojne tek impjanti i trajtimit te ujerave te perdorura. Impjanti i dekantimit do te sherbeje per dekantimin e pluhurave dhe materjaleve te ngurta qe mund te kene rene ne ujin e perdorur, si dhe kapjen e vajerave edhe grasove qe mund te dalin nga pjeset mekanike te pajisve. Impjanti i trajtimit konsiston ka dy dhoma dhe nje puset shkarkimi. Dhoma e pare sherben per te siguruar dekantimin e

pare te sedimenteve dhe per te kapur vajerat dhe grasot pluskues dhe dhoma e dyte per te kapur sedimentet mbetese. Gropa e dekantimit do te kete edhe sistem per kapjen e vaj-grasove. Ujerat qe dalin nga gropa e dekantimit do te largohen me nje sistem tubacioni te mbyllur per ne trup ujore qe kalon prane aktivitetit.Me poshte po japim nje skice te impjantit te trajtimit te ujerave.





Figura 6. Skica e impjantit te trajtimit te ujerave te perdorura
 Nga zhvillimi i aktivitetit nuk pritet te kete ndikime negative ne sistemin e kanalizimeve te Njesise Administrative Fushe Kruje.



c. Shkarkimet ne ajer.


Nga zhvillimi i aktivitetit te nuk pritet te kete shkarkime pikesore te qenesishme ne ajer. Ky aktivitet nuk ka procese diegie apo perdorim te kaldajave, pra nuk do kete perdorim te lendeve djegese dhe nuk do te kete shkarkime nga oxhaqe te gazeve te diegies. Lende te tjera te mundeshme per tu shkarkuar ne ajer jane pluhuri total dhe PM₁₀. Keto mund te rezultojne nga procesi i shkarkimi dhe levizjes se mbetjeve ne prendesi te subjektit.

d. Zhurmat.

Nga zhvillimi i aktivitetit pritet te kete leshime zhurmash nga ngarkimi apo levizja e mbetjeve, levizja e makinerive, puna e makinerise se shtypjes se karkasave te makinave te perdorura, cekicet dhe cekanet e punonjesve gjate cmonimit te motorrve apo pjeseve te ndryshme. Gjithesesi kompania do te marre masa qe keto zhurma te mos jene mbi normat e lejuara dhe te mos ndikojne ne mjedisin e zones perrreth. Pajisjet dhe makinerit qe perdoren ne brendesi te fabrikes jane te dizenuara qe te jene ne perputhje me normat e lejura te zhurmave ne ambientet industriale 70-110 dBA. E njejta gje eshte edhe per vibracionet, te cilat jane te paperfillshme. Edhe aktiviteti i ngarkim shkarkimit dhe manovrimit te automjeteve qe sjellin mbetjet apodo bejne transportimin e mbetjeve te ndara shkaktin nivele te paperfillshme te zhurmes per punonjesit dhe banoret e zones. Gjithashtu duhet te mbajet parasysh fakti qe ky aktivitet eshte i vendosur ne zonen industriale te Fushe Kruje dhe gjendet ne ane te atuostrades Kamez-Fushe Kruje.

e. Fenomene te tjera.

Nuk aplikohet



f. Gjenerimi i mbetjeve

Nga zhvillimi I aktiviteti do te krijohen mbetje te ndryshme, te ambalazhimeve te ndryshme, sedimete nga impjanti i trajtimit te ujerave te perdorura, si dhe mbetje te ngashme me ato urbane. Mbetjet tipike qe do te gjeneohen nga ky aktivitet jepen ne kapitullin 4. Gjithsesi gjate muajve ne vazhdim subjekti do te raportoje me ane te raporteve te vetemonitorimit mjedisor cdo 6 muaj mbi te dhenat e mbetjeve dhe sasite e gjenerimit te tyre.

Shijaku sh.a ka lidhur marreveshje bashkepunimi me shume kompani per tu marre apo shitur materiale te ndryshme.

g. Ndikime ne biodiversitet.

Meqenese aktiviteti i zhvillohet brenda dhe ne teritorin e sistemuar te kompanise nuk pritet te kete ndikime ne biodiversitetin e zones.

4. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;

a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.

Nga ky aktivitet pritet te gjenerohen ujera te perdorura perdorura per qellime higjene dhe pastrim te ambienteve subjektit. Per mbledhjen e ketyre ujrave subjekti ka ndertuar nje sistem kanalizimesh qe perfundojne tek impjanti i trajtimit te ujerave te perdorura. Impjanti i dekantimit do te sherbejne per dekantimin e pluhurave dhe materjaleve te ngurta qe mund te kene rene ne ujin e perdorur, si dhe kapjen e vajerave edhe grasove qe mund te dalin nga pjeset mekanike te pajisve.





Tabela 3. Evidentimi i ujerave te ndotura

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime te ujerave te ndotura?		X	Nga ky aktivitet nuk ka ujera te ndotura. Te vetme ujera te perdorura jane ujerat qe perdoren per qellime higjene dhe pastrimit te abjenteve te kompanise. Subjekti do te ngrrej nje impjant te trajtimit te ujerave te perdorura per qellime higjene.
A ka ujera te ndotura me natyre toksike?		X	Nuk ka.
A behen shkarkime ne rrjetin e kanalizimeve?		X	Ne afersi te zones nuk ka sisteme te rrjetit te kanalizimeve. Subjekti ka ndertuar grope septike per ujerat e zeza. Boshatisja e saj do te behet ne menyre periodike nga pale te treta.
A behen shkarkime ne siperfaqet ujore?	X		Ujerat e perdorura per larjen e mjediseve te jashtme te fabrikes si dhe ujerat e perdorura per qellime higjiene ne mjediset e subjekti trajtohen ne impjantin e trajtimit te ujit. Ujerat e trajtura i bashkohen nje trupi uJOR qe kalon ne afersit te subjektit. Subjekti ka sistemuar ambientet e jashme dhe ujerat e shirave jane kanalizuar qe te bashkohen me tubacionin qe nxjerre ujerat e trajtuara nga subjekti perpara se te derdhen ne trupin uJOR qe kalon ne afersi te subjektit.
Jepni sasine e ujerave te ndotura (m ³ / dite)	X		Sasia e ujerave te perdorura mund te shkoje deri ne 3 m ³ /dite. Aktualisht uji sigurohet me bote nga pale te treta. Subjekti eshte ne proces te konsiderimit te




			alternativave te tjera deri ne shtrirjen e rrjetit te ujesjellesit qe aktualisht mungon ne zone.
--	--	--	--

b. Shkarkimet ne ajer.

Nga shkarkimet ne ajer mund te kete emetime te shperndara ne ajer te pluhur total dhe PM₁₀. Subjekti do te siguroj monitorimi jo te vazhduar per matjen e pluhurit total SPM dhe te fraksioneve te PM10 ne ambientet e punes si dhe ne periferi te subjektit.

Tabela 4. Evidentimi i shkarkimeve ne ajer

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime ne ajer (nga oxhaqet) ?		X	Nuk ka perdorim te lendeve djegese apo impjante per diegien e tyre. Nuk ka oxhak.
A ka shkarkime nga burime te shperndara?	Po		Nga ky aktiviteti mund te emetohen pluhura ne nivele te paperfillshme dhe te perkohshme Mund te emetohen gazet e dieges se automjeteve qe do te perdoren per frunizimin me lende te para apo transportin e produktit. Keto sasi jane te paperfillshme.
A ka erera te keqija?		Jo	



c. Zhurmat.

Gjate zhvillimit te aktivitetit mund te gjenerohen zhurma. Burimet kryesore te zhurmave te gjeneruara gjate zhillimi te aktivitetit permendim:

- Mjetet e transportit qe sjellin ose ngarkojne materiale nga subjektit;
- Pajisja e shtypjes se karkasave te makinave;
- Perdoimi i cekiceve dhe cekaneve gjate zmontimit te pjeseve te ndryshme.


Te gjitha pajisjet, makinerit dhe mjetet e transportit jane te dizenuara qe te mos shkaktojne zhurma mbi normat e lejuara ne fuqi.

Tabela 5. Zhurmat gjate aktivitetit te subjektit

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen zhurma?	Po		Mund te kete gjenerim te zhurmes gjate fazes se funksionimit. Nga puna e pajisjeve te shtypjes se akrkasave te makinave, makinerive te transportimit etj. Subjekti do te pajise personelin me mjetet e mbrojtjes personale si dhe trainoj ata per sigurine dhe shendetin ne pune.
A gjenerohen vibracione?		Jo	Nuk ka vibracione

h. Fenomene te tjera.

Nuk aplikohet.




i. Gjenerim i mbetjeve

Gjate zhvillimit i aktiviteti mund te gjenerohen mbetje. Aktiviteti kryesor i subjektit do te jet grumbullimi i mbetjeve, zmontim/ndarje e sistem ne ambiente te dizenuara dhe te percaktuara nga subjekti. Qellimi i aktivitetit eshte grumbullimi, magaznimi i perkoheshem dhe shitja e ketyre mbetjeve perdoruesve te mundshem. Ne tabelen nr 5.

Tabela 6: Te dhena per mbetjet

Gjenerimi i mbetjeve						
Nr	Lloji I mbetjeve	Numri I katalogut	Sasite (t, kg, m3, cope, meter/linear etc) e mbetjeve	Trajtimi i metejshem ne vendndodhje	Riperdorimi, riciklimi dhe trajtimi ne vendndodhje	Metoda e asgjесimit/trajtimit ne vendndodhje
1	Mbetje ambalazhi dhe kartoni	15 01 01	1.7 kg/dite	Nuk kryhet trajtimi ne vendndodhje	-	Grumbullim, trasportim ne venddepozitimin e njesise vendore
2	Mbetje ambalazhi dhe plastike	15 01 02	1.4 kg/dite	Nuk kryhet trajtimi ne vendndodhje	-	Grumbullim, trasportim ne venddepozitimin e njesise vendore
3	Mbetje ambalazhi te perbera	15 01 05	-	Nuk kryhet trajtimi ne vendndodhje	-	Grumbullim, trasportim ne venddepozitimin e njesise vendore
4	Mbetje ambalazhi	15 01 06	1.6 kg/dite	Nuk kryhet	-	Grumbullim, trasportim ne venddepozitimin e



				trajtimi ne vendndodhje		njesise vendore
5	Goma jashtë përdorimit	16 01 03 (VKM 99)	Nga çmontimet e makinave të cilat vijnë nga gomat	5000kg	Ruhen në një vend specifik në subject. Keto jane stok ne teritorin e percaktuar te kompanise tone.	
6	Vajra	13 02 (VKM 99)	Nga automjetet, dhe makinerit	10000 litra	Ruhen ne Kazane të posaçem si stok ne teritorin e	

Rr. Donika Kastrioti Str. Building No.14/1, 3th Floor,
Ap.6, Tirane.Tirane, Web:<http://shijakugroup.al/>,
Email: shijakushpk@hotmail.com,

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania
email: aconsultantal@gmail.com ; web:
aconsultant.com.al Cel: 0696032083



					kompanise tone.	
7	Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21 dhe 20 01 23 që përmbajnë komponentë të rrezikshëm	20 01 35* (VKM 99)	Nga automjetet, dhe makinerit	0 kg	Ruhen si stok në një kosh për depozitimin e plastikës ne kompanine tone	

Te gjitha mbetjet e tjera te aneksit 1 jane objekt per tu grumbulluar dhe shitur ne perdorues ose trajtues te tjere te mundshem.

Rr. Donika Kastrioti Str. Building No.14/1, 3th Floor,
Ap.6, Tirane.Tirane, Web:<http://shijakugroup.al/>,
Email: shjakushpk@hotmail.com,

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania
email: aconsultantal@gmail.com ; web:
aconsultant.com.al Cel: 0696032083

5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;

Punimet per ndertimin e gjithe godines dhe shtrimin e siperfaqeve te betonit jane kryer ne vite, ndersa gjate ketij aktiviteti do te behen modifike dhe pershtatje te ambjenteve ekzistuese. Gjate funksionimit te aktiviteti nuk pritet te kete ndikime te genesishme. Ne cdo rast ndikimet e identifikuar do te zgjasin per aq kohe sa do te zhvillohet ky aktivitet. Me perfundimin e ketij aktiviteti nuk do te kete ndikime. Ndikimet e identifikuarqe mund te ndodhin gjate punimeve per pershtatjen e ambjenteve dhe gjate funksionimit do te adresohen nga subjekti nepermjet marrjes se masave zbutese si dhe nepermjet programit dhe sistemit te manaxhimit mjedisor. Kryesisht subjekti do te perdor kontenier te formave te ndryshme sikurse jane spjeguar ne projektin teknik. Per cdo kontenier ku do te magazinohen lende lengeshme do te sigurohet qe te jen ne dopio kontainer per te shmangur largimine lengjeve ne rast aksidenti.

6. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;

Ndikimet e mundeshme qe mund te rezultojne nga ky aktivitet jane te karakterit lokal dhe nuk shtrihen ne zona te tjera perreth aktivitetit. Nga funksionimii aktivitetit nuk pritet te kete ndikime te genesishme qe mund te perhapen ne kohe dhe ne hapsire ne zonen e projektit apo me gjere. Zhvillimi i aktivitetit nuk sjell ndikime te mundshme hapsinore, te cilat mund te nenkuptohen ne distancen fizike nga vendndodhja e projektit.

7. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;

Megjense i gjithe aktiviteti do te zhvillohet ne brendesi dhe siperfaqe aktuale te objektit te Shijaku, ne perfundim te funksionit te ketij aktivitetit per te rehabilituar kete siperfaqe subjekti do te kryej:

- largimine makinerive dhe pajisjeve;
- largimin e cdo mbetje dhe materiali;
- largimine platformave prej betoni apo cdo materiali tjeter, mbetje ndertimi apo hekuri nga vendet ku ka patur nderhyrje ne objekt;
- kthimin e objektit ne gjendjen perpara fillimit te aktivitetit.

Ne varesi te destinacionit te funksionit te ardhem te ketij objekti, subjekti do te kryej ndryshimet dhe modifikimet e duhura te objektit.

Ne rast se do te priset objekti ose do te behet I paperdorshem subjekti duhet ta kthej teritorin ne perputhje me natyren e zones perrreth ose ne gjendjen e meparshme. Ne kete rast nje nder masat kryesore te rehabilitimit mjedisor eshte mbjellja e barit ose pyllezimet. Mbjellja e barit eshte nje aktivitet I thjesht ndersa mbjellja e bimeve dhe pyllezimi ka nevoj per vendosje kriteresh dhe pecaktim te llojeve qe do perdoren per pyllezim ku mund te permendim:

- zgjidhen e lloje vendase, autoktone mundesisht te kene pershtatje ndaj kushteve stacionale me vetite biosilvike te llojit;
- te jene te pershtatshem lehtesisht ndaj ndryshimeve klimatike;

- rezistente ndaj semundjeve dhe demtueseve;
- per vete objektin ku mbillen, te jene rezistente ndaj pluhurave;
- te durojne thatesiren dhe ngricat;
- mundesisht te jene gjethembajtes, ose kombinim i tyre.

Duke pasur parasysh zonen fitoklimatike te vend shtrirjes se objektit me qellim krijimin e grumbujve te gjelbert, qe do te sherbejne jo vetem per qellime mbrojtese por edhe per qellime te tjera si psh dhe per permiresimin e mikroklimes, projekti parashikon kultivimin e specieve qe gjejne kushte te pershtatshme zhvillimi. Harmonizimi i kushteve stacionale qe na ve ne dispozicion objekti me vetite biosilvike te llojeve, por dhe te qellimit kryesor krijimin e grumbujve pyjore, me specie te tilla pyjore, na lejon ti japim preference kultivimit ne objekt te kulturave te tilla si: frasher, lloje te tjere dushqesh qe jane autoktone nga bimet drusore, por duke marre ne konsiderate edhe lloje te tilla haloresh si p.sh pishat, te cilat kane treguar nje plasticitet shume te kenaqshem ne mbjelljet ne grumbuj pyjore qe jane realizuar ne afersi te ketij territori ne kodrat e Krujes dhe qe kane rezultuar me nje rritje mjaft te kenaqshme vjetore. Pra, me shume interes eshte mbjellja e ketyre llojeve haloresh ose lloje te tjera permesh me rritje te shpejt per tu perdorur per qellime ernergetike apo per mobilje.

Ne ndertimin e skemes se pyllzimit mbahen parasysh mjaft faktore ku mund te permendim disa :

- karakteristikat e terrenit;
- vetite biologjike te llojit;
- shpejtesine e rritjes se llojit;
- jetegjatesine e llojit;
- diemensionet e rritjes se specieve si ne lartesi por dhe ne hapesire;

- sistemin rrenjor;
- menyren e riprteritjes se tyre ne te ardhmen;
- forma e kurores;
- qellimi i mbjelljes se pishes eshte si per mbrojtje te tokes, per qellime dekorative, rehabilitim terrenesh, kombinim te ketyre kerkesave;





Figura 7: Mbjellja e fidaneve

Gjate hapjes se gropave dheu i gërmuar do të vendoset i ndarë nga njeri-tjetri (ne shtresa). Në mbjelljen e fidanit shtresa e sipërme hidhet në fund të gropës. Mbjellja e fidanave do të bëhet duke i mbushur gropat plotësisht me dhe dhe duke e ngjeshur mirë rreth fidanit. Duke qene se tokat jane shume te varfra ne lende ushqyese, do te perdoret nje sasi plehu kimik (DAP) në një sasi prej 50-100 gram DAP/fida ose 50-150 kg per 1 ha ne menyre qe te plotesojme nevojat e fidaneve per lende kimike dhe organike. Pas mbulimit te plote me dhe fidani duhet te vaditet me uje. Fidanet qe do mbillen do jene nje ose dy vjecare. Një hu i shkurtër do te përdoret për të siguruar mbështetjen e nevojshme derisa kërcelli i drurit të bëhet i fortë dhe i papërkulur.



Gropat do të hapen 1 muaj para mbjelljes së fidanave, me qëllim që ato të rrihen nga agjentët atmosferikë. Mbjellja e fidanave do të kryhet në periudhën e pushimit të vegetacionit (Nentor - Shkurt). Gjithsesi, në raste të veçanta kjo periudhë mund të jetë edhe më e gjatë, në varësi të kushteve të motit. Nuk do të mbillen fidana në kohë me ngrica dhe lagështi të madhe, kur gropat janë të mbushura me ujë.

Për të ndihmuar zhvillimin sa më të mirë të fidanave dhe sigurimin e një përqindjeje sa më të lartë në zënien e tyre, është e domosdoshme kryerja e shërbimeve kulturore në 2 vitet e para pas mbjelljes. Këto do të konsistojnë në 2 prashitje dhe 2 vadingje në vitin e parë, 1 prashitje dhe 1 vadingje vitin e dytë dhe përdorim plehrash kimike apo organik. Prashitja do të bëhet me rreze 0.5 m e thellësi 10-15 cm. Koha e kryerjes së prashitjeve do të jetë periudha Prill-Qershor. Rekomandohet që prashitjet të bëhen 2-3 ditë pas rënies së shirave, në mënyrë që të ruhet sa më shumë ujë në gropë. Në rastet e thatësirës verore, në sipërfaqen e mbjelljes duhet bërë vadingje duke shfrytëzuar ujin e burimeve ose perrenjve me të afert.

Në lidhje me kostot e mbjelljes së pemëve subjekti ka bërë një plan shpenzimesh për ha sipas tabelës





Tabela 7. Kosto te detajuar te mbjelljes se bimeve

Nr.	Procesi i punes	Njesia e matjes	Volumi	Norma ditore	Dite pune	Paga/cmimi	Vlefte
1	Piketim gropash.	cope	700	180	3.8	1200	4,560
2	Hapje gropash 40 x 40 x 40 cm	cope	700	30	23.8	1200	28,560
3	Mbjellje fidane ne gropa 40 x 40 x 40 cm	Cope	700	60	11.6	1200	13,920
4	Transport me mjet (fidanishte – objekt)	rruge	1	-			8,000
5	Transport fidane me qeska distance 50 m						5,100
	SHUMA I						60,140
6	Sigurime shoqerore 16.7 %						10,043
	SHUMA II						70,183
7	Baza materiale						
8	Blerje fidana	Cope	200			62	12400

Rr. Donika Kastrioti Str. Building No.14/1, 3th Floor, Ap.6, Tirane.Tirane, Web: <http://shijakugroup.al/>, Email: shijakushpk@hotmail.com,


Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania email: aconsultantal@gmail.com ; web: aconsultant.com.al Cel: 0696032083



	ilqe 1-2 vjecar						
9	Blerej fidane dafine 2-3 vjec	Cope	200			130	26000
10	Blerje fidane pise mesdhetare 2-3 vjecare	Cope	300			110	33000
11	Blerje piketa druri	Cope	700				5,000
	SHUMA III						76,400
	SHUMA I+II+III						206,723
12	Fitimi 10 %						24,726
13	SHUMA IV						231,449
	T.V.SH 20 %						46,290
TOTALI							277,739

Rr. Donika Kastrioti Str. Building No.14/1, 3th Floor,
Ap.6, Tirane.Tirane, Web: <http://shijakugroup.al/>,
Email: shijakushpk@hotmail.com,

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania
email: aconstantal@gmail.com ; web:
aconstantal.com.al Cel: 0696032083



Nje permbledhje e kostove te pergjithseshme te kthimit te teritorit ne gjendjen e meparshme jepet ne tablene e meposhteme:

Tabela 8. Kosto te detajuar te mbjelljes se bimeve

Nr.	Procesi i punes	Vlefte
1	Largim pajisjes dhe makinerish te linjes se bojerave	500,000
2	Largim lendesh te para dhe produkte	200,000
3	Largim platformash, mbetjesh, te fabrikes se bojerave, etj	300,000
4	Prishje e objektit	700,000
5	Largim mbetjesh te objektit	400,000
6	Mbjellje bari dhe pyllezim per ha	277,739
7	Shuma totale	2,277,739

8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;

Per minimizimin e ndikimeve ne mjedis gjate fazes se funksionimit kompania ka pergatitur dhe do te implementoj Planin e Menaxhimit Mjedisor (PMM). Te gjitha aktiviteti do te realizohen ne perputhje me kete plan.

- Identifikimi i masave zbutese.

Nga ushtrimi i aktivitetit prodhim boje kemi ndikime ne mjedis dhe masat zbutese te propozuara per tu ndjekur nga kompania, qe jepen te permbledhura ne tabelen 7.

Tabela 9. Permbledhje e ndikimeve dhe masave zbutese

Faza	Ndikimi	Masa zbutese	Kostot e masave	Pergjegjësia
Funksionim	Ndikimi ne cilesine ajerit.	Do te vendosen sisteme ventilimi dhe	Perfshihet ne kostot e	Shijaku sh.a

Rr. Donika Kastrioti Str. Building No.14/1, 3th Floor, Ap.6, Tirane.Tirane, Web: http://shijakugroup.al/ , Email: shijakushpk@hotmail.com,	Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania email: aconsultantal@gmail.com ; web: aconsultant.com.al Cel: 0696032083
--	---

	Nga aktiviteti mund te emetohen ne ajer pluhur dhe PM10	aspirimi ne cdo ambient pune; Do te kryhen monitorime cdo 6 muaj per cilesine e ajerit te mjedisit dhe te ambienteve te punes	funksionimit	
Funksionim	Zhurma. Aktiviteti qe zhvillohet nuk gjeneron nivele te larta te zhurmave domethenese per zonen perreth	The gjitha pajisjet dhe mjetet jane te disenjuara per te patur nivele te emetimit te zhurmave brenda internalit 70-110 dBA; Punjesit do te jene per pajisje me mjetet e mbrojtjes personale (kufje, etj)	Perfshihet ne kostot funksionimit	Shijaku sh.a
